

Vendim nr. 32, datë 28.01.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Ilir Toska, Anëtar

Genti Ibrahim, Anëtar

në datën 28.01.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 24 (M) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **MHILL PLLUMBAJ**, përfaqësuar nga avokat Saimir Vishaj, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 2058 (5161), datë 02.11.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; nr. 128, datë 27.05.2022 të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2025-993, datë 12.06.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 31, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 50, pika 4, 51/a, pika 1, shkronja b, 71, 71/a, 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është arrestuar në flagrancë në datën 14.07.2020, pasi në grindje e sipër ka qëlluar me armë zjarri dhe ka plagosur lehtë dy shtetas (atë e bir), për shkak se ata kishin parkuar automjetin përpara portës së banesës së tij. Gjatë hetimeve paraprake janë kryer një sërë veprimesh hetimore, si këqyrja e vendit të ngjarjes, ku janë gjetur dhe sekuestruar arma e zjarrit e llojit pistoletë, municione, gëzhoja dhe njolla gjaku; ekspertimet mjeko-ligjore të dy shtetasve të plagosur, sipas të cilave ka rezultuar se dëmtimet e tyre ishin shkaktuar me armë zjarri dhe se ato u kishin shkaktuar paaftësi të përkohshme për punë mbi 9 ditë; ekspertimi tekniko-balistik i sendeve të sekuestruara në vendngjarje, sipas të cilit pistoleta ishte në gjendje të rregullt teknike, ndërsa gëzhojat ishin qitur prej saj; sekuestrimi i pamjeve filmike të regjistruara nga kamerat e sigurisë në vendngjarje dhe ekspertimi kompjuterik i tyre, të cilat tregonin veprimet e kërkuesit dhe të viktimave; ekspertimi kimik mbi faktorët plotësues në duart e kërkuesit; verifikimi i lejes që kërkuesi kishte për mbajtjen e armës së zjarrit; marrja e deklarimeve nga viktimat dhe bashkëshortja e kërkuesit.

2. Në datën 28.12.2020 kërkuesi i është drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër (*Prokuroria e Shkodrës*) me kërkesë për kryerjen e ekspertimit psikiatrik psikologjik të tij për të verifikuar gjendjen psikike dhe afektin fiziologjik në kohën e kryerjes së veprës penale. Kërkesa është pranuar nga prokurori dhe sipas aktit të ekspertimit psikiatrik ligjor të datës 22.04.2021, të kryer nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, Tiranë, është arritur në përfundimin se kërkuesi nuk plotësonte kriteret diagnostike për sëmundje të shëndetit mendor, ishte i përgjegjshëm përpara ligjit dhe në gjendje të merrte pjesë me vetëdije në procedimin penal. Gjithashtu, sipas aktit të ekspertimit, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe në vlerësimin e kryer, nuk kishte të dhëna që kërkuesi, para, gjatë ose pas kryerjes së veprës penale,

të ishte diagnostikuar ose trajtuar për sëmundje të shëndetit mendor dhe as të ishte prekur nga afekti fiziologjik.

3. Pas zhvillimit të hetimeve paraprake, Prokuroria e Shkodrës i ka njoftuar kërkuesit akuzat e veprave penale të vrasjes me dashje në tentativë dhe të plagosjes së lehtë me dashje, të parashikuara nga nenet 76 e 22, si dhe 89 të Kodit Penal (KP), pasi ka arritur në përfundimin se kërkuesi kishte gjuajtur 5 herë me armë zjarri pistoletë në drejtim të një prej viktimave, nga një distancë fillestare prej afërsisht 2 metra dhe në gjuajtjen e fundit (të pestë) mbi 5 metra, duke shkaktuar plagosjen e të dyve. Vepra penale e vrasjes me dashje e njëjës prej viktimave ka mbetur në tentativë për shkaqe të pavarura nga vullneti i kërkuesit, konkretisht për shkak të largimit me vrap të viktimës. Në vijim, prokurori ka paraqitur në gjykatë kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq, kërkesë e cila është pranuar.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka pranuar kërkesën e kërkuesit për gjykimin e shkurtuar të çështjes dhe, në përfundim, me vendimin nr. 2058(5161), datë 02.11.2021, ka vendosur deklarinimin fajtor, sipas akuzave, dhe pas uljes së dënimit me një të tretën e ka dënuar përfundimisht me 7 vjet e 4 muaj burgim. Kërkuesi ka paraqitur apel kundër vendimit, duke kërkuar ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale të vrasjes me dashje në tentativë në atë të plagosjes së lehtë me dashje, të parashikuar nga neni 89 i KP-së.

5. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 128, datë 27.05.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë për sa i takon cilësimit juridik të veprave penale dhe deklarinimit fajtor të kërkuesit, por ka ndryshuar masën e dënimit, duke e ulur atë në 6 vjet e 8 muaj, për shkak të disa rrethanave lehtësuese.

6. Ndonëse kërkuesi ka paraqitur rekurs, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-993, datë 12.06.2025, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se shkaqet e ngritura nuk parashikoheshin nga neni 432, pika 1, i Kodit të Procedurës Penale (KPP).

7. Në datën 14.11.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar më 19.11.2025.

II

Pretendimet e kërkuesit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

- 8.1. *E drejta e aksesit substancial*, pasi gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të tij.
- 8.2. *E drejta për ankim efektiv*, pasi ankimi në gjykatën e apelit dhe rekursi në Gjykatën e Lartë nuk kanë rezultuar mjete efektive.
- 8.3. *E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi gjyqtarët nuk duhet të paragjykonin çështjen e shtruar përpara tyre.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuesit

9. Çështja e legjitimitit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, ndaj, në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Kolegji evidenton se gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë dhe shterues për kërkuesin. Thënë ndryshe, mund të ndodhë që në shqyrtimin paraprak të një çështjeje të verifikohet mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, me pasojë moskalimin e saj në seancë plenare. Edhe pse kriteret e legjitimitit kanë të njëjtën peshë në këtë fazë të shqyrtimit paraprak, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që të vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë

plenare, kjo nuk nënkupton se në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i më shumë se një kriteri, ato humbasin rëndësinë dhe karakterin kumulativ të tyre.

11. Në rastin konkret, Kolegji çmon të ndalet në analizën e legjitimitetit *ratione materiae*, duke evidentuar se kërkuesi ka pretenduar se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e aksesit substancial, së drejtës për ankim efektiv dhe të gjykatës së paanshme. Mirëpo, për këto pretendime, kërkuesi është mjaftuar vetëm me paraqitjen e referencave në jurisprudencën e Gjykatës për secilën nga të drejtat kushtetuese të pretenduara, pa paraqitur ndonjë argument dhe rrethanë faktike konkrete për të mbështetur pretendimin për cenimin e këtyre të drejtave. Në këtë pikë, Kolegji thekson se gjykimi kushtetues është i natyrës argumentuese, që do të thotë se i takon kërkuesit të parashtrojë argumentet faktike mbi të cilat mbështet pretendimet e tij (*shih vendimet nr. 57, datë 25.07.2017; nr. 42, datë 25.05.2017; nr. 45, datë 29.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Me fjalë të tjera, vetëm fakti se kërkuesi është individ i dënuar me vendim përfundimtar penal nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, nuk mjafton nga pikëpamja kushtetuese për të vënë në dyshim respektimin e garancive për një proces të rregullt ligjor, për rrjedhojë pretendimet e tij janë haptazi të pabazuara.

12. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.